

**Pranimi i përgjegjësive të mia si
Punëdhënësi i siguruesve të mi individualë –
Versioni i përkohëshëm i epidemisë së COVID**

**Acknowledgement of My Responsibilities As The Employer of My Individual
Providers –Temporary COVID pandemic version**

Zgjedh të marr shërbime nga Siguruesi Individual (IP) i paguar nga Departamenti i Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore (DSHS). E kuptoj se përgjegjësitë e mia si punëdhënësi i IP tim përfshijnë:

Kontrollet e të kaluarës së siguruesve të mi:

- E kuptoj se IP im duhet të kalojë si një kontroll të së kaluarës brenda shtetit, por se kërkesa për gjurmët e gishtërinye kur vjen nga jashtë shtetit tani hiqet për shkak të epidemisë së COVID-19. Mund të punësoj IP tim që të fillojë menjëherë ose të pres për rezultatet e kontrollit të gjurmëve të gishtërinye. Nëse punësoj IP tim përpara marrjes së rezultateve të gjurmëve të gishtërinye dhe siguruesi im gjendet të jetë i skualifikuar, DSHS nuk do të paguajë më atë IP. Kam mundësinë që të zgjedh një IP tjetër që kualifikohet:

- Dëshiroj të punësoj IP me njohurinë se kërkesa për gjurmët e gishtërinye kur vjen nga jashtë shtetit tashmë është hequr për shkak të epidemisë së COVID-19. E kuptoj se IP im fillimisht duhet të kalojë përmes kontrollit të së kaluarës brenda shtetit.** Kontrolli i së kaluarës brenda shtetit shqyrton; (1) rregjistrat e shpalljes fajtor për vepra penale përmes Patrullave të Shtetit të Washington-it, (2) rregjistrat në bazën e të dhënave të Gjykatave të Shtetit të Washington-it dhe (3) rezultatet nga agjencitë shtetërore të Washington-it.
OSE
- Dëshiroj të pres derisa kontrolli i gjurmëve të gishtërinye jashtë shtetit ka përfunduar përpara marrjes në punë të IP tim.** Kontrolli jashtë shtetit përfshin një kontroll të rregjistrave të veprave penale në shtete të tjera.

Emri i IP: _____

Të gënit një punëdhënësi:

- Duhet të kontrolloj dhe të marr në punë një IP të kualifikuar;
- Duhet të kontaktoj administratorin e rastit tim për t'u siguruar se IP ka një kontratë të vlefshme;
- E kuptoj se IP im nuk lejohet të punojë nëse marrin njoftim nga DSHS se nuk të ndalojnë punën;
- E kuptoj se IP im nuk lejohet të punojë nëse nuk kualifikohen më si një IP;
- E kuptoj se do të marr një njoftim nëse IP im nuk lejohet të punojë. Nëse i lejoj të punojnë pas datës së atij njoftimi, mund të jem vetëm unë përgjegjës për pagesën e IP;
- Jam siguruar se IP im mund të punojë në Shtetet e Bashkuara. Duhet të plotësoj dhe të ruaj formularin I-9. Mund të kontaktoj [Faqen në Internet të Sigurisë së Atdheut USCIS I-9](#) ose duke telefonuar në 1-888-464-4218 nëse kam nevojë për më shumë informacion;
- E kuptoj se mund të kontaktoj Rregjistrin e Referimit për Kujdesin në Shtëpi (HCRR) për ndihmë në gjetjen e një IP. Ky shërbim është i disponueshëm në shumicën e rajoneve të shtetit. Mund të kontaktoj HCRR përmes telefonit në 1-800-970-5456. Mund të kontaktoj HCRR në Internet në: <http://www.hcrr.wa.gov/>

Planfikimi i IP tim për punë:

- E kuptoj se IP im **nuk mund** të punojë më shumë sesa kufiri javor i punës i tyre pa miratim nga DSHS;
- E kuptoj se IP im ka vetëm një kufi javor të punës. IP im nuk mund të kapërcejë këtë kufi edhe nëse punojnë për persona të tjerë përveç meje;
- Duhet të sigurohem se IP im nuk është duke punuar më shumë sesa kufiri javor i punës i tyre dhe më shumë sesa orët e mia javore të shërbimit;
- Duhet të gjej një dhënësi të kujdesit rezervë për të përmbushur nevojat e mia, kur kam nevojë për një të tillë;
- Mund të duhet të marr në punë dhënësi të kujdesit shtesë për të përmbushur nevojat e mia dhe për të respektuar rregullat e kohës shtesë;
- Duhet të sigurohem se IP im e kupton planin e kujdesit tim, mund të ndjekë planin e kujdesit tim dhe mund të punojë me planin që dëshiroj;

- Mbikqyr punën e IP tim. Edhe pse IP im ka një kontratë me DSHS, DSHS nuk mbikqyr IP tim.

Sigurimi i dorezave:

- Duhet të siguroj doreza për IP tim për detyrat e kujdesit personal me prekje të duarve kur ato nevojiten:
- Mund të marr deri në 200 doreza në muaj nga përfitimi im Apple Health (Medicaid). Mund të jem në gjendje të marr edhe më shumë nëse është e nevojshme nga ana mjekësore.
- Nëse kam një kujdes të administruar nga Apple Health (Medicaid), mund të kontaktoj planin tim të shëndetit ose doktorin tim për të porositur doreza ose të shkoj tek <https://www.hca.wa.gov/assets/billers-and-providers/13-010.pdf>
- Nëse kam mbulim të Apple Health që nuk është përmes kujdesit të administruar mundet që:
 - T'i telefonoj një furnizuesi të pajisjeve mjekësore nga lista në faqen në Internet të Autoritetit të Kujdesit Shëndetësor në: https://www.hca.wa.gov/assets/billers-and-providers/ffs_providers_non_sterile_gloves.pdf ose
 - T'i telefonoj doktorit tim; ose
 - T'i telefonoj Qendrës së Shërbimit Mjekësor në 1-800-562-3022. Ky numër gjendet në pjesën e pasme të Kartës time blu të Shërbimit Mjekësor. Për më shumë informacion mbi marrjen e dorezave, shkoni në faqen në Internet të Autoritetit të Kujdesit Shëndetësor në <http://www.hca.wa.gov/medicaid/dme/Pages/default.aspx>.

Detyrat financiare:

- E kuptoj se DSHS nuk është përgjegjëse për mbajtjen ose pagimin e taksës mbi të ardhurat për IP tim përveç kur IP im i kërkon atij t'a bëjë këtë;
- DSHS është përgjegjës për mbajtjen dhe pagesën e taksave të Sigurimit Shoqëror dhe Medicare (FICA);
- DSHS është përgjegjës për mbajtjen dhe pagimin e taksave federale dhe shtetërore të papunësisë (FUTA/SUTA) përveç kur IP është prindi im ose fëmija im që është ndërmjet moshës 18 dhe 21 vjeç;
- Duhet të njoftoj për pagesat e pjesëmarrjes të Kujdesit tim Personal tek agjencitë shtetërore dhe federale të taksave nëse:
 - Marr shërbimet e mia përmes Shërbimeve në Shtëpi dhe Komunitet ose nga Agjencia ime vendore e Zonës për të Moshuarit (AAA), dhe
 - Punësoj një IP, dhe
 - Paguaj për pjesëmarrjen për shërbimet e mia të Kujdesit Personal.
 - Për informacion të taksave, kontaktoni Shërbimin e të Ardhurave të Brendshme në 1-800-829-1040 ose Departamentin Shtetëror për Sigurimin e Punësimit të Uashingtonit në 1-888-836-1900.

Komunikimi me DSHS:

- Do të kontaktoj Administratorin e Rastit tim nëse:
 - Kam shqetësime në lidhje me planin e kujdesit tim ose për cilësinë e kujdesit që jam duke marrë nga IP im;
 - Nuk jam duke marrë shërbimet për të cilat po më faturon IP;
 - Nuk jam duke marrë shërbimet e autorizuara në planin e kujdesit tim;
 - Dëshiroj të ndryshoj ose të shtoj një sigures të shërbimit;
 - Kam nevojë për ndihmë me marrjen në punë/administrimin e IP tim; ose
 - Dëshiroj të caktoj më shumë orë për IP tim sesa kufiri javor i punës së tij/saj.

Gjithashtu e kuptoj se kam një të drejtë të bëj apel nëse DSHS më mohon zgjedhjen time të siguresit të shërbimit.

NËNSHKRIMI I KLIENTIT / PËRFAQËSUESIT LIGJOR DATA

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË KLIENTIT

EMRI ME GËRMA TË MËDHA I KLIENTIT / PËRFAQËSUESIT LIGJOR